



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:064304

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05435591

P.nr. 322/24

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit, K.O, për shkak të veprës penale “Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314, paragrafi 6 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 77 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës me kërkesë për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr. 7091/2023 te datës: 16.02.2024, gjykata jashtë seancë më datë: 04.03.2024 mori dhe përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 7091/2023 te datës: 16.02.2024, si dhe kjo gjykatë konform nenit 495 të KPPRK-së, jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të akuzuarit:

K.O nga i ati S, i lindur me datë “data e lindjes”, me banim në rr. “emri i rrugës” nr..... në Prishtinë, i gjendjes se dobët ekonomike, me numër personal “letërnjoftim”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me datë 05.10.2023, në rrugën “rruga” nr..., në Prishtinë, i pandehuri me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, është hasur në shtëpinë e tij duke e shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar, gjatë kontrollës së realizuar nga zyrtarët e KEDS-it, në atë mënyrë që ka bërë anashkalimin e njësisë matëse-njehsorit elektrik me nr. 44890635 dhe është furnizuar direkt me energji dhe në këtë mënyrë ka shpenzuar energji elektrike pa matje

me qëllim që rryma e shpenzuar të mos regjistrohet dhe faturohet fare, me ç' rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 543.28euro.

-Me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale “Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, si dhe nenit 181 par.2 të KPRK, si dhe neneve 365 dhe 493, 495, 496, të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

### DENIM ME GJOBË

- I. I akuzuari K.O, dënohet me dënim me gjobë në shumën prej 150 (njëqind e pesëdhjete) Euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
- III. Pala e dëmtuar KEDS, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.
- IV. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor në shumë prej 20.00 (njëzet) Euro, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 20.00 (njëzetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 7091/2023 te datës: 16.02.2024, ndaj të akuzuarit K.O, për shkak të veprës penale “Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314, paragrafi 6 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 77 të KPRK-së, si dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, që vërtetojnë faktin se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ose ne qoftë se gjykata nuk e shqipton urdhrin ndëshkimor, ka propozuar që të caktojë dhe mbajë seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata pasi shqyrtoi përmbajtjen e aktakuzës me kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor nga ana e organit të ndjekjes, gjeti se e njëjta është përpiluar në përputhje me nenin 493 të KPPRK-së, andaj erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet nga neni 495 i KPPRK-së, që në këtë çështje penale pa u mbajtur fare shqyrtimi gjyqësor të marrë vendim për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor ndaj të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se i akuzuari, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale K.O, për shkak të veprës penale “Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314, paragrafi 6 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale, kjo është vërtetuar, duke u bazuar edhe në prova të cilat gjinden në shkresat e lëndës. Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Kallëzimi Penal CMS-K/DPR-639, i datës 23.11.2023 procesverbali i marrjes në pyetje të të dyshuarit i datës: 07.02.2024, Raporti i incidentit i datës: 05.10.2023, Informacionet e personit, foto dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Të gjitha këto janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat, gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë, ashtu siç është propozuar nga prokurori i shtetit në kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor, mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69, 70 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës të dëmtuar në kontest civil është marrë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 462 par.2 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1 të KPRK-së ndërsa lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 39 par 3, pika 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 08/L-109).

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364, 365, 452, 462, 493, 495, të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal  
P.nr. 322/24, datë: 04.03.2024

Bashkëpunëtori Profesional:  
Asdren Selmani

Gjyqtari:  
Sabit Sadikaj

KËSHILLË JURIDIKE: I akuzuari ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.